

Statistikat e transportit*

Maj 2022

Tiranë, më 28 Qershor 2022: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Maj 2022 është 345,4 mijë ton, duke u ulur me 13,9 %, krahasuar me Maj 2021.

Në pesëmujorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.771,7 mijë ton, duke u ulur me 8,4 %, krahasuar me pesëmujorin e parë të vitit 2021.

Në muajin Maj 2022, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.618 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 35,1 %, krahasuar me Maj 2021.

Në pesëmujorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 8.357 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 35,4 %, krahasuar me pesëmujorin e parë të vitit 2021.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Transporti i mallrave		
	Me det / ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër / ton *
Maj 2021	401.258	2.495	196,1
Maj 2022	345.406	1.618	161,1
Ndryshimi vjetor (%)	-13,9	-35,1	-17,8
Janar-Maj 2021	1.933.260	12.931	806,4
Janar-Maj 2022	1.771.733	8.357	817,4
Ndryshimi vjetor (%)	-8,4	-35,4	1,4

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në muajin Maj 2022, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 161,1 ton, duke u ulur me 17,8 %, në krahasim me Maj 2021.

Në pesëmujorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 817,4 ton, duke u rritur me 1,4 %, krahasuar me pesëmujorin e parë të vitit 2021.

Në Maj 2022, numri i fluturimeve të kryera është 3.588, duke u rritur me 2,2 herë, në krahasim me muajin Maj 2021.

Për publikim 28/06/2022

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Maj 2021	14	1.610	6.086
Maj 2022	17	3.588	19.645
Ndryshimi vjetor (%)	21,4	122,9	222,8
Janar-Maj 2021	14	5.952	22.810
Janar-Maj 2022	17	12.938	61.086
Ndryshimi vjetor (%)	21,4	117,4	167,8

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në Maj 2022, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 65.599 pasagjerë. Krahasuar me Maj 2021, ky tregues është rritur me 80,2 %. Në pesëmujorin e parë të vitit 2022, kanë udhëtuar me linjë detare 240.873 pasagjerë, duke u rritur me 55,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Në Maj 2022, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 1.882 pasagjerë. Krahasuar me Maj 2021, ky tregues është rritur me 2,9 herë. Në pesëmujorin e parë të vitit 2022, kanë udhëtuar me linjë hekurudhore 7.626 pasagjerë, duke u rritur me 3,4 herë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Në muajin Maj 2022, transporti ajror i pasagjerëve zë 87,0 % të transportit gjithsej.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Maj 2022 është 450.796 pasagjerë, duke u rritur me 2,9 herë, krahasuar me Maj 2021. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në pesëmujorin e parë të vitit 2022 është 1.598.066 pasagjerë, duke u rritur me 3,2 herë, krahasuar me pesëmujorin e parë të vitit 2021.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Maj 2021	643	36.406	152.842
Maj 2022	1.882	65.599	450.796
Ndryshimi vjetor (%)	192,7	80,2	194,9
Janar-Maj 2021	2.239	155.121	495.646
Janar-Maj 2022	7.626	240.873	1.598.066
Ndryshimi vjetor (%)	240,6	55,3	222,4

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Maj 2022, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 124,6 mld lekë ku 51,9 % e tyre u transportua me det.

Në pesëmuajorin e parë të vitit 2022, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 571,9 mld lekë ku 51,2 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Maj 2022, mallrat e eksportuara me det zënë 57,6 %, me tokë 35,5 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me tokë në Maj 2022 janë rritur me 22,0 %, krahasuar me Maj 2021.


Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Eksport (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Maj 2021	17.157	0.05	13.083	84	2.533
Maj 2022	25.862	1.09	15.957	87	3.025
Ndryshimi vjetor (%)	50,7	2.108,1	22,0	2,9	19,4
Janar-Maj 2021	78.209	1.34	52.775	350	10.437
Janar-Maj 2022	116.856	1.09	72.350	474	17.312
Ndryshimi vjetor (%)	49,4	-18,8	37,1	35,1	65,9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në pesëmuajorin e parë të vitit 2022, mallrat e eksportuara me det zënë 56,5 %, me tokë 35,0 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me tokë janë rritur 37,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Maj 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Importet e mallrave

Në Maj 2022 mallrat e importuara me det zënë 48,7 %, me tokë 45,7 % dhe me ajër 2,5 %.

Mallrat e importuara me tokë në Maj 2022 janë rritur me 23,6 %, krahasuar me Maj 2021.


Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Import (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Maj 2021	29.948	205	29.465	1.917	408
Maj 2022	38.820	193	36.412	1.996	2.249
Ndryshimi vjetor (%)	29,6	-5,9	23,6	4,2	451,8
Janar-Maj 2021	134.039	1.449	137.539	9.297	4.710
Janar-Maj 2022	175.917	534	159.675	8.647	20.101
Ndryshimi vjetor (%)	31,2	-63,2	16,1	-7,0	326,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në pesëmujorin e parë të vitit 2022, mallrat e importuara me det zënë 48,2 %, me tokë 43,8 % dhe me ajër 2,4 %, Mallrat e importuara me tokë janë rritur me 16,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021,

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Maj 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti, Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transporti tokësor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues dhe përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi, Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(,,,) mungesë të dhënash